



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:269518

Datë: 01.09.2021

Numri i dokumentit: 02134273

A.nr.1006/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me sekretaren juridike Sanie Salihu, në konfliktin administrativ të paditësit “A. P. S. K.”- Zyra në Kosovë- Obiliq, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A. Sh. Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, në ri gjykim sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nr. AA nr.63/2014 datë 12.04.2018, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e pjesshëm të vendimit, me objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur në prani të autorizuarit të palës paditëse avokat A. Sh .dhe në mungesë të palës së paditur, me datës 23.08.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “A. P. S. K.”- Zyra në Kosovë- Obiliq, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A. Sh. Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET PJESËRISHT Aktvendimi nr.58/2009 i datës 23.06.2010, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë dhe atë lidhur me ngarkesën e obligimeve tatimore në kategorinë e Tatimit të Paragjykuar për periudhën TM3/2000 deri më TM1/2002 dhe Tatimit në Fitim për vitin 2002, dhe lënda në këtë pjesë kthehet ne RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE
- III. PEZULLOHET procedura gjyqësore në pjesën tjetër të padisë së paditësit “A. P. S. K.”- Zyra në Kosovë- Obiliq, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A. Sh. Avokat në Prishtinë në këtë konflikt administrativ ku është kërkuar anulimi i vendimit nr. 53/2009 i datës 30.04.2010 të Administratës Tatimore të Kosovës

me seli në Prishtinë, lidhur me periudhat tatimore të Tatimit në Korporata për vitin fiskal 2007 dhe 2008, Tatimit të Mbajtur në Burim për periudhën 01/2003 deri më 12/2007 dhe Kontributeve Pensionale për periudhën 08/2003 deri më 12/2007 sipas Njoftim Rivlerësimeve përkatëse të ATK-së, ngase paditësi ka hequr dorë nga kjo pjesë e padisë.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë konflikt administrativ.

### A r s y e t i m

Më 23 gusht 2021, Gjykata për këtë lëndë të konfliktit administrativ, e në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale neni 81.B, i ligjit nr. 04/L-102, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222, dhe nenit 17, të ligjit nr. 06/L054 për Gjykatat, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor. Seanca publike është mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit e në mungesë të palës së paditur. Gjykata konstaton se çështja në këtë lëndë të konfliktit administrativ zhvillohet sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.63/2014 e dt.12.04.2018, sipas të cilit aktgjykim anulohet aktvendimi i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime A.nr.102/2010 i dt.29.06.2012 dhe lënda i kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative – Divizionit Fiskal në rigjykim dhe rivendosje, për ta vlerësuar ligjshmërinë e tani vendimit kontestues nr.58/2009 i dt.30.04.2010, ndërsa parashtresa e dt.23.06.2010 e ushtruar në atë kohë pranë Bordit të Pavarur për Rishqyrtime tani në këtë lëndë të konfliktit administrativ konsiderohet padi.

Paditësi “A. P. S. K.”- Zyra në Kosovë- Obiliq me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 23.06.2010, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, në të cilën ka deklaruar se nuk pajtohet me asnjë nga konkluzionet e raportit të kontrollit dhe se ajo që shkruhet në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit kontestues nuk e reflekton plotësisht përmbajtjen e ankesës së drejtuar në ATK, apo natyrën reale të sqarimeve të cilat paditësi i ka elaboruar. Sa i përket konkluzioneve nga 1 deri në 9 të këtij raporti, konsideron se asnjëra nga këto nuk përputhet me ligjin e zbatueshëm në Kosovë apo rregullave të zbatueshme ndërkombëtare. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe përmes parashtresës së

datë 23.08.2021 të dorëzuar në seancën gjyqësore, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit kërkon që të aprovohet padia e paditësit, të lirohet paditësi nga ngarkesat e obligimeve tatimore në kategorinë e Tatimit të Paragjykuar për periudhën TM3/2000 deri TM1/2002 dhe në kategorinë e tatimit në fitim për vitin 2002. Tutje deklaron se obligimet tjera sa i përket Tatimit në të Ardhura të Korporatave për vitin 2007 dhe 2008, Tatimit të Mbajtur në Burim për periudhën 01/2003-12/2007 dhe Kontributeve Pensionale për periudhën 08/2003-12/2007 sipas Njoftimit për Rivlerësim të ATK-së janë përmbushur dhe nuk janë objekt i mëtejshëm i shqyrtimit të kësaj çështje gjyqësore, andaj pika 3 e petiumit të propozuar me parashtrësë si në këtë seancë korrigjohet si vijon: paditësi për shkak të pagesës së plotë të detyrimeve tatimore heq dorë pjesërisht nga padia dhe atë që i referohet tatimit në të ardhura të korporatave për vitin 2007 dhe 2008, tatimit të mbajtur në burim për periudhën 01/2003 deri 12/2007 dhe kontributeve pensionale për periudhën 08/2003 deri 12/2007 sipas njoftim të rivlerësimeve të ATK-së nga regjioni Prishtina 2, andaj i propozoi gjykatës që për këtë pjesë të nxjerrë aktvendim për pezullimin e procedurës siç është përcaktuar në nenin 31 par.1 të LKA-së.

E paditura përmes parashtrësës së datës 23.08.2021 ka kërkuar nga Gjykata që pas administrimit të provave të merr aktgjykim me të cilin Anullohet në tërësi Aktvendimi i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime nr.102/2010 i datës 29.06.2012 dhe të mbetet në fuqi Vendimi i Administratës Tatimore të Kosovës nr.58/2009 i datës 30.04.2010. Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor në rivendosje në mungesë të palës së paditur komfor dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se pala e paditur përmes parashtrësës së datës 23.08.2021 e ka njoftuar gjykatën që nuk do të merr pjesë në seancën gjyqësore dhe ka kërkuar që të veprohet konform nenit 38 paragrafi 5 të LKA-së (provë: parashtrësja e datës 23.08.2021 nga ATK-ja).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 23.08.2021, ka administruar provat dhe atë: Raporti i kontrollit i datës 21.12.2009, Aktvendimi i BPR-së A.nr.102/10 i datës 29.06.2012. Vendimi i ATK-së nr.58/2009 i datës 30.04.2010, Parashtrësja e BPR-së e datës 11.12.2014, Ankesa e ushtruar në ATK e datës 26.02.2010, Shënim për Aktivitetin e inspektorit i datës 04.02.2009, Parashtrësja v

ATK-së e datës 03.02.2009, Dokumenti i kërkesës së informatave i datës 04.02.2009, E-mail-at e datës 03.02.2009 dhe 26.01.2009, Dokumenti i Vendosjes së Ndëshkimit për periudhën tatimore 12/2008 e datës 30.12.2009, Parashtrësia e ATK-së e datës 13.04.2010, Fletat e punës listat e kontratave të realizuara në Kosovë 2000-2002, Njoftim Rivlerësimet për kategorinë pensionet për periudhën 08/2003 deri 12/2007, Kopjet e deklaratave të TVSH-së për Tatimin në Burim dhe Tatimin e Mbajtur në Burim, Parashtrësia me shkrim e datës 23.08.2021, Marrëveshja për pagimin e borxheve tatimore me këste e datës 15.06.2011, Vërtetimi tatimor nr.1000808074/17.08.2021.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, në seancën e mbajtur me datë 23.08.2021 vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta në pikat kontestuese në këtë lëndë të konfliktit administrativ, të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestues nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes administrative në shqyrtim, dhe një arsyetim i tillë lidhur me pikat kontestuese për Gjykatën është i mangët dhe i pa qartë dhe kontradiktor. Gjykata vlerëson se aktvendimi i atakuar përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, dhe si i tillë edhe nuk mund të ekzaminohet, e sidomos nëse nuk është konstatuar drejtë gjendja faktike, si dhe kur provat nuk janë të arsyetuara veç e veç dhe të ndërlidhura së bashku, andaj doemos edhe është dashur të anulohet.

Nga Raporti i Kontrollit i datës 21.12.2009 gjykata konstaton se paditësi është ngarkuar me tatim shtesë në këto lloje të tatimeve: Tatimi i Paragjykuar në vlerë prej 242,697.07€ për periudhën TM3/2000 dhe TM2/2001, Tatimi në Fitim në Vlerë prej 141,590.06€, Tatimi në të Ardhura të Korporatave në vlerë prej 172,878.55€ për vitin 2007 dhe 2008,

Tatimi i Mbajtur në burim për Paga në vlerë prej 9,760.14€ për periudhën 2007 dhe 2008, Tatimi i Mbajtur në Burim në paga në vlerë prej 6,372.80€ për periudhën 08/2003-12/2007.

Nga ekzaminimi ne shkresat e lëndës vërtetohet se paditësi para se të krijoj njësinë e përhershme në Kosovë me regjistrim në MTI me datë 05.07.2007, ka zhvilluar aktivitet ekonomik në Kosovë në bazë të katër kontratave të lidhura me Agjensionin Evropian për Rindërtim dhe vlera e përgjithshme e këtyre kontratave arrin në 7,234,439.00€. Në të gjitha këto kontrata palë kontraktuese është A. në Francë në njërën anë dhe Agjensionin Evropian për rindërtim në anën tjetër. Nga vendimi kontestues dhe dokumentacioni ne shkresat e lëndës Gjykata e ka të paqarte se si Administrata Tatimore e Kosovës, këtu e paditura ka vlerësuar dhe vërtetuar kohëzgjatjen e punëve të realizuara nga këtu paditësi përmes këtyre kontratave brenda cilësdo periudhë një vjeçare. Gjykata vlerëson si të paqëndrueshëm dhe pa bazë ligjore arsyetimin e dhënë ne tri pikat 1, 2 dhe 3 të vendimit kontestues duke iu referuar nenit 1 “përkufizimi” të rregullores 2000/29, nenit 18.1 të Ligjit 2004/48 dhe nenit 2 të Rregullores 2002/3, për arsye se nuk është dhënë asnjë arsye se si është vërtetuar se paditësi është obligues tatimor si person jo rezident dhe i cili nuk ka krijuar njësi të përhershme në Kosovë dhe si është vlerësuar aktiviteti ekonomik më tepër se 90 ditë gjatë një viti kalendarik.

Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, Gjykata pasi ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimeve të të paditurës, nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete.

Gjykata konstaton se vendimi nr. 58/2009 i datës 30.04.2010, në pikat kontestuese nuk përmban arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. E paditura në arsyetim të vendimit kontestues ka përshkruar vetëm bazën ligjore por duke anashkaluar faktet e pakontestueshme se paditësi në bazë të aktivitetit të zhvilluar në Kosovë, ka qenë apo nuk ka qenë i obliguar të krijoj njësi të përhershme sipas rregullores dhe ligjeve në fuqi, e nga e cila kishte me rrjedh edhe e drejta apo detyrimi për tu obliguar për tatim të paragjykuar, dhe tatim në fitim. E

paditura një konstatim të tillë do të duhej ta bazonte në prova dhe dëshmi konkrete dhe jo ti mjaftonte vetëm përshkrimi i bazës ligjore ngase ky arsyetim si i tillë konsiderohet si i pa-qartë e pa evitimin e të cilës nuk mund të procedohet tutje.

Konventa nr.14417 në mes të Francës dhe ish Jugosllavisë për shmangien e tatimit të dyfishtë neni 5 pika (g) parasheh “Çdo vend ndërtimi, projekt konstruksioni, montimi apo instalimi ose aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me këtë, që zgjasin më shumë se 12 muaj...” që në rastin konkret në bazë të këtij neni paditësi nuk ka qenë i obliguar të regjistroj njësinë e përhershme në Kosovë, duke marr parasysh natyrën e punëve të kryera. Tutje në nenin 145 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet “Marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet tjera për bashkëpunim ndërkombëtar, që janë në fuqi në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të vazhdojnë të respektohen deri atëherë kur ato marrëveshje ose akte të ri negociohen ose kur të bëhet tërheqja nga to ne pajtueshmëri me kushtet e tyre deri atëherë kur ato të zëvendësohen nga marrëveshje ose akte tjera ndërkombëtare me të cilat mbulohen fushat e njëjta që janë miratuar në pajtim me këtë Kushtetutë”.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj Gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me çështjet si më lartë dhe të trajtoj dhe vlerësoj edhe njëherë tatimin e paragjykuar për periudhën TM3/2000 deri më TM1/2002, dhe Tatimin në fitim për vitin 2002, si dhe dispozitat ligjore e cila i mundëson të tejkaloj vlerësimin e periudhën 6 vjeqare.

Sa i përket padisë së paditësit në pjesën ku është kërkuar fillimisht me padi anulimi i vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës anulimi i vendimit nr. 53/2009 i datës 30.04.2010 të Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë, lidhur me periudhat tatimore të Tatimit në Korporata për vitin fiskal 2007 dhe 2008, Tatimit të Mbajtur në Burim për periudhën 01/2003 deri më 12/2007 dhe Kontributeve Pensionale për periudhën 08/2003 deri më 12/2007 sipas Njoftim Rivlerësimeve përkatëse të ATK-së, Gjykata vendosi si në pikën tre të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për pezullim e procedurës gjyqësore në këtë pjesë të padisë në këtë konflikt administrativ, në përputhje me dispozitat e nenit 31 par.1 të LKA-së, për arsye se paditësi ka heq dorë nga kjo pjesë

e padisë përmes përfaqësuesit të autorizuar deklaruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor, prandaj, Gjykata nuk është lëshuar më tej në vendosje lidhur me këtë pjesë sipas padisë në këtë konflikt administrativ.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*.

Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon pjesërisht aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje lidhur me pikat kontestuese. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenin 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal

1006/18, datë 23.08.2021

Sekretare Juridike

Sanie SALIHU

\_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

\_\_\_\_\_

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.